



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 655/ 10 Prot.

Datë 23.04.2026

V E N D I M
Nr. 543 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.04.2026, mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.415/2026, datë 24.03.2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-76992-02-23-2025, me objekt: Blerje Kompjuter, pritera, me fond limit 1,645,500 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 06.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

Ankimues: Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK me NIPT L82428011G dhe adresë: Rruga: “Fortuzi”, Nr.66/1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Maliq
Adresa: Bulevardi Rinia, Maliq.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766 datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 415/2026, datë 24.03.2026, ku vendosi:

- 1. Mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-76992-02-23-2025, me objekt: Blerje Kompjuter, pritera, me fond limit 1,645,500 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 06.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.*
 - 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” ShPK për procedurën e prokurimit sipërcituar.*
 - 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik si dhe të publikojë shtojcën në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.*
 - 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
 - 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Blueprint Technologies” ShPK.*
 - 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
 - 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Nëpërmjet shkresës Nr.1786/1 prot., datë 03.04.2026, protokolluar me tonën nr. 655/7 prot., datë 09.04.2026, Autoriteti kontraktor informon në lidhje me zbatimin e vendimit të KPP-së dhe statusin e procedurës së prokurimit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Nëpërmjet shkresës Nr.1786/1 prot., datë 03.04.2026, protokolluar me tonën nr. 655/7 prot., datë 09.04.2026, Autoriteti kontraktor informon në lidhje me zbatimin e vendimit të KPP-së dhe statusin e procedurës së prokurimit.

II.2. Referuar shkresës sipërcituar për zbatim vendimi AK informon në mënyrë të përmbledhur si vijon: *[...]Në përgjigje të shkresës tuaj mbi dërgimin e vendimit të nr.prot 655/6, date 24.03.2026, kërkojmë të hiqet pezullimi i procedurës së prokurimit “Blerje Printera”. Njësia e prokurimit do të bëjë anulimin e procedurës së prokurimit, Ndryshimet e dokumenteve standarde të tenderit sipas Vendimit të KPP-së dhe publikimin e procedurës në*

SPE. Bashkëlidhur shkresës, Urdheri nr.178, dt.02.04.2026 i Kryetarit të Bashkisë Mbi zbatimin e vendimit të KPP-së Nr. 415/2026.[...]

II.3. Referuar shkresës sipërcituar si edhe verifikimeve në SPE, autoriteti kontraktor nuk ka publikuar shtojcën mbi modifikim të dokumenteve të tenderit, sikurse citohet në Vendimin e Komisionit si edhe bashkëlidhur shkresës, autoriteti nuk ka dërguar shtojcë, mbi modifikimet e dokumenteve të tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik i ndodhur në këto kushte duke qenë se AK nuk ka publikuar shtojcë për modifikim të dokumenteve të tenderit, si edhe për faktin që KPP ka dalë me vendimin nr. 415/2026 mbi trajtimin e pretendimeve të ankesës, të ndodhur para një shtate të tillë, Komisioni gjykon, se Autoriteti Kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe të dërgojë pranë KPP-së kopje të DST së re me ndryshimet përkatëse, në përputhje me vendimin e KPP-së për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligji nr. 162/2020 «Për Prokurimin Publik», i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 12.10.2021“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor me vijimin me hapa të mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-76992-02-23-2025, me objekt: Blerje Kompjuter, pritera, me fond limit 1,645,500 Lekë pa TVSH, për tu zhvilluar me datë 06.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.
 2. Autoritetin kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit dhe përpara ripublikimit të dërgojë në KPP, Setin e Dokumenteve Standarde të reja me të gjitha ndryshimet përkatëse në zbatim të Vendimit të KSHA-së dhe Vendimit Nr.415/2026, datë 24.03.2026 të KPP-së.
 3. Autoriteti kontraktor të njoftojë Komisionin mbi veprimet e kryera.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

